



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.07.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 503, datë 22.11.2022, për kandidatën znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 5. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 6. Alban Toro*** (anëtar)
- 7. Marçela Shehu*** (anëtare)
- 8. Brikena Ukperaj*** (anëtare)
- 9. Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 503, datë 22.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Atëherë, po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni nga ana e Këshillit do të merren sot për shqyrtim 11 çështje. Pa humbur kohë nëse s’keni diskutime mbi rendin, ku në fakt kam vetëm unë një propozim. Duke qenë se ka disa kërkesa për sa i përket disa gjykatave në nevojë për caktimin e gjyqtarëve për çështje të veçanta, t’i përfshijmë këto kërkesa ditën e sotshme, pasi të mbarojmë çështjet e rendit të ditës? Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Naureda Llagami: Atëherë vijojmë me çështjen e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, për kandidatën znj. {...}. Fjalën ia jap z. Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Parashtroj relacionin “Për tërheqjen e kandidatës, znj. {...} nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502/503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Me vendimet nr. 502, 503, datë 21.11.2022 të Këshilli i Lartë Gjyqësor, është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë respektivisht në fushën e së drejtës penale, apelit Durrës në fushën e së drejtës penale dhe po në të drejtën penale në Gjykatën e Apelit Korçë. Është lënë afati kohor për të kandiduar dhe brenda këtij afati ka kandiduar edhe gjyqtarja {...}, e cila aktualisht është gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Pasi janë kryer procedurat (nuk po e lexoj të gjithën pasi të gjithë anëtarët janë të njohur) si, shorti, problematikat nëse ka papajtueshmëri në lidhje me ndonjë anëtar apo relatorin e çështjen, për të cilat kanë rezultuar negative, është vijuar me procedurat e tjerat ku në vijim të procedurës për tre kriteret formale të kandidatës {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të përmendura më lart në fushën e të drejtës penale, me vendimin nr. 274, datë 25.05.2023 KLGJ ka vendosur: Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e

3

lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë për sa i përket këtyre pozicioneve.

Me verifikimin e tre kritereve, nga ana e Këshillit kanë vijuar procedurat e verifikimit të kritereve ligjore të pasurisë dhe figurës, të cilat janë në proces e sipër.

Rezulton që, kandidatja znj. {...}, gjatë zhvillimit të procedurave të verifikimit të kritereve ligjore të pasurisë dhe figurës, me shkresën e paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, protokolluar me nr. {...}, datë 14.06.2023 dhe shkresën nr. {...}, datë 14.06.2023, ka shprehur vullnetin e saj mbi tërheqjen nga kandidimi në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 503, datë 22.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, procedurë e cila është në proces. Patur parasysh kërkesat për tërheqje nga kandidimi, ajo parashtroi: “...në kushtet kur në datën 24.05.2023 nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë shpallur katër vende të lira për ngritje në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ju paraqes tërheqjen time nga kandidimi për këtë pozicion...”.

Në rrethanat e mësipërme, kur kandidatja është në procedurën e verifikimit të kritereve ligjore, u përgatit relacioni bazuar në pikën 17, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit nr. 75/2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në seancë plenare.

Në këto kushte relatori ia ka parashtuar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe ky Komision më datë 27.06.2023 ka vendosur kalimin në seancë në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur përfundimin e kësaj procedure për pozicionet e shpallura më vendimet nr. 502 dhe nr. 503, datë 22.11.2022, për kandidaten, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të relatorit.

Ilir Rusi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord. (*Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet në audio, por e kontaktuar nëpërmjet e-mailit ka konfirmuar votën e saj “dakord”. Për efekt të procesverbalit e-maili i konfirmimit të votës i bashkëlidhet procesverbalit të siglosur.*)

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatori.

* * *

(Pika 1 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.07.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e kandidatës znj. {...}, nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës” / “Për dërgimin e emrit të kandidatës e cila ka aplikuar për t’u komanduar në pozicionin “pedagog i brendshëm” në Shkollën e Magjistraturës”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Marçela Shehu* (anëtare)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e kandidatës znj. {...}, nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës” / “Për dërgimin e emrit të kandidatës e cila ka aplikuar për t’u komanduar në pozicionin “pedagog i brendshëm” në Shkollën e Magjistraturës”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me përjashtimin e kandidatës znj. {...}, nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës. Për më shumë detaje, fjalën ia jap sërish zotit Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Po parashtoj opinionin mbi kandidaten që ka aplikuar për t’u komanduar në Shkollën e Magjistraturës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 86, shkronja “d” dhe nenin 264 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe ligjit “Për statusin”, si dhe në kërkesën e Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 275, datë

25.05.2023 ka vendosur: “Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar data 9 qershor 2023. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur vetëm një kërkesë, konkretisht kërkesa e znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila është protokolluar pranë Këshillit me aktin nr. {...} prot., datë 10.02.2023.

Në këtë kërkesë znj. {...} ka parashtruar kërkesën për leje lidhur me kandidimin për pozicionin “Pedagog i brendshëm me drejtim formimin vazhdues të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, pranë Shkollës së Magjistraturës”.

Në këtë kërkesë ajo thekson që plotëson kriteret ligjore lidhur me kandidimin, duke qenë se: (i) ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2013-2014 me vlerësimin “shumë mirë” dhe është renditur e para si nga kandidatët për gjyqtarë ashtu edhe në renditjen totale të 17 magistratëve, (ii) sqaron se në muajin tetor 2023, plotëson kriterin e ushtrimit të profesionit prej 10 (dhjetë) vitesh si gjyqtare. Lidhur me plotësimin e këtij kriteri, ajo ka parashtruar që, duke qenë se viti akademik 2022-2023 ka përfunduar, dhe komandimi do të ketë efekt për vitin akademik 2023-2024, që fillon në muajin tetor 2023, kur plotëson kriterin ligjor lidhur me vjetërsinë, sipas saj nuk ka pengesë në paraqitjen e kandidaturës; (iii) gjithashtu parashtron që është konfirmuar me vendim të formës së prerë nga organet e rivlerësimit kalimtar, (iv) nuk ka masa disiplinore dhe që (v) ka bashkëpunim të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës.

Mbi vendimin për hapjen e procedurës

Në vendimin nr. 275, datë 25.05.2023 të Këshillit, konkretisht në Kreun II të tij, është përcaktuar edhe procedura që do të ndiqet nga Këshilli. Për vlerësimin e kushteve të kandidimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit. Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre.

Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendosë përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të komandimit. Emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim, me përjashtim të atij të mësimdhënies, së bashku me Opinionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe dokumentacionin e paraqitur prej tyre, i përcillen menjëherë për vlerësim Shkollës së Magjistraturës.

Vlerësimi i kriterit të komandimit të mësimdhënies dhe i kriterëve shtesë për pozicionin vakant si më sipër, bëhet nga Shkolla e Magjistraturës, në zbatim të Rregullores së Brendshme të miratuar prej saj. Shkolla e Magjistraturës njofton kandidatin për depozitimin pranë saj të çdo dokumentacioni tjetër shtesë, me qëllim vlerësimin e plotësimin të kriterëve të tjera të parashikuara në Aneksin 11 të Rregullores së Shkollës.”

Sipas parashikimit të bërë në pikën 7 të Kreut II, Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell Shkollës së Magjistraturës emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim, me përjashtim të atij të mësimdhënies, së bashku me Opinionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe dokumentacionin e paraqitur prej tyre, i përcillen menjëherë për vlerësim Shkollës së Magjistraturës”.

Në pikën 9 dhe 10 të këtij Kreu, parashikohet se: “Përzgjedhja e kandidatit për vendin vakant në pozicionin e pedagogut të brendshëm, bëhet me vendim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Rezultatet e verifikimit

Në respektim të procedurës që duhet të ndiqet sipas vendimit nr. 275, datë 25.05.2023 të Këshillit në fazën e parë, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin.

Në këto rrethana Komisioni i Zhvillimit të Karrierës harton projekt-opinionin për kandidaten, si vetmja kandidate që ka aplikuar. Sa më sipër, në përgatitjen e këtij opinionin për këtë kandidate, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, verifikon ekzistencën ose jo të ndonjë prej kushteve ndaluese si dhe vlerëson cenimin apo dëmtimin e

funksionalitetit të gjykatës ku ushtron detyrën gjyqtari që ka paraqitur kërkesën për komandim, si edhe vlerëson kriteret e tjera të komandimit përveç mësimdhënies.

Në lidhje me kushtet ndaluese të komandimit

Kushtet e komandimit përcaktohen në nenin 53, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Po ashtu ato janë përcaktuar në pikën 3, Kreu II të Vendimit të Këshillit nr. 275, datë 25.05.2023. Konkretisht, kushtet e komandimit janë:

a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;

b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;

c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;

ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë: i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit; nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;

d) Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi.

Lidhur me sa më lart, nga ana e Këshillit është kërkuar përmes komunikimit, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit janë kërkuar të dhënat personale të kandidates dhe rezultoni se: zonja ({...}), ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 12.07.2010 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014. Me dekret nr. {...}, datë 21.10.2013 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. {...}, datë 25.09.2015 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 9 vite. Zonja {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për komandim pranë Shkollës së Magjistraturës, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 275, datë 25.05.2023, rezultoni të

mos jetë në një pozicion me mandat të kufizuar, rezulton të mos jetë e komanduar, nuk ka qenë e komanduar më parë, si dhe rezulton të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Verifikimi i kriterit të moscenimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesi të lartë) të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin -

Sa i përket cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të gjykatës ku kandidata ushtron funksionin, nga informacioni e mendimi i marrë nga zëvendëskryetari i gjykatës, përmes komunikimit elektronik të datës 26.06.2023, rezulton se: "...Në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ushtrojnë detyrën 12 (dymbëdhjetë) gjyqtarë. Me vendim të Këshillit të Gjykatës është bërë ndarja e gjyqtarëve në dhomë e seksione dhe gjyqtarja znj. {...} është caktuar në seksionin civil.

Në këtë gjykatë mbetet problematikë numri i lartë i çështjeve që kanë në shqyrtim gjyqtaret. Zonja {...} ka në shqyrtim mbi 480 çështje. Në dijeninë time, thuhet në shkresën e kryetarit, KLGJ është në proces për lëvizje paralele të katër gjyqtarëve në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në cilësinë e Zv/Kryetarit të Gjykatës, vlerësoj se gjyqtarja Znj. ({...}) i ka aftësitë e duhura për të qenë pjesë e stafit të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, si pedagoge e brendshme. Do ishte e udhës që komandimi i saj në Shkollën e Magjistraturës të bëhej menjëherë pas lëvizjes paralele të gjyqtarëve në këtë gjykatë, pasi e kundërta do të cenonte funksionalitetin e gjykatës e konkretisht seksionin ku bën pjesë gjyqtarja."

Verifikimi i kriterëve të komandimit-

Në pikën 7, Kreu II, pika 8 të vendimit 40/2023, është parashikuar se: "Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell Shkollën së Magjistraturës emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim. Lidhur me kriteret e komandimit për pozicionin "Pedagog i brendshëm", janë si vijon:

a) Kandidati duhet të ketë eksperiencë pune mbi pesëmbëdhjetë vjet si jurist, gjyqtar, prokuror, avokat dhe eksperiencë mësimdhënie si pedagog i brendshëm në sistemin universitar ose pedagog i jashtëm ose i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, mbi dhjetë vjet; ose

b) Kandidati, që ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, duhet të ketë eksperiencë mbi dhjetë vjet si gjyqtar dhe eksperiencë mësimdhënie universitare në lëndët kryesore ose në Shkollën e Magjistraturës mbi pesë vjet.

Kriteret e përzgjedhjes janë përcaktuar në nenin 264 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Aneksin 11 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, ku parashikohet eksperiencia mbi 10 vjet. Kjo referohet në nenin 264.

Ndërkohë në Aneksin 11, të Rregullores përcaktohet që:

Pedagogët e brendshëm mund të zgjidhen:

-juristë më të shquar; me eksperiencë mbi 15-vjeçare si gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe me eksperiencë mësimdhënëse apo në Shkollën e Magjistraturës mbi 10 vjet.

Sipas informacionit të përmendur më lart, rezulton se znj. {...} është caktuar përkohësisht në detyrë më datë 21.10.2013, pra ka vjetërsi në detyrë 9 vjet e 7 muaj (deri në këto momente). Ndërkohë, në kërkesën për kandidim të paraqitur nga ajo, sqaron se në muajin tetor 2023, plotëson kriterin e ushtrimit të profesionit prej 10 (dhjetë) vitesh si gjyqtare. Lidhur me plotësimin e këtij kriteri, ajo ka parashtruar që, duke qenë se viti akademik 2022-2023 ka përfunduar, dhe komandimi do të ketë efekt për vitin akademik 2023-2024, që fillon në muajin tetor 2023, kur plotëson kriterin ligjor lidhur me vjetërsinë, sipas saj nuk ka pengesë në paraqitjen e kandidaturës.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për komandim pranë Shkollës së Magjistraturës, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 275, datë 25.05.2023, rezulton të ketë vjetërsi në detyrë 9 vjet e 3 muaj, duke mos plotësuar kështu kriterin e pasjes së “eksperiencës mbi 10 vjet”, si gjyqtar.

Bazuar sa më sipër, në zbatim të pikës 6, të vendimit nr. 275, datë 25.05.2023 të Këshillit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Përfundimisht e kandidatës znj. {...}, nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës. Varianti tjetër: T’i dërgohet Shkollës së Magjistraturës emri i znj. {...}, e cila ka aplikuar për t’u komanduar, në pozicionin “Pedagog i brendshëm” në Shkollën e Magjistraturës, si dhe praktikën dokumentare të paraqitur prej saj.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të sjellë nga relatori.

Ilir Rusi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e kandidatës znj. {...} nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës për shkak të mosplotësimit të kriterit të vjetërsisë mbi 10 vjet.

2. Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.07.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017-2019, relator z. Ridvan Hado.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Fatmira Luli***, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Irena Plaku***.

14

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 06.07.2023 (Pika 3)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017-2019, relator z. Ridvan Hado.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek projekt-akti tjetër i cili ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional për periudhën 2017-2019, për gjyqtarin {...}. Për më shumë detaje, fjalën ia jap relatorit zotit Ridvan Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Propozim lidhur me nivelin e vlerësimit për periudhën 2017-2019 të gjyqtarit {...}.

Me materialet besoj jeni njohur.

Po kaloj direkt në mënyrë koncize për kriteret përkatëse.

Propozimet e mia:

Aftësitë profesionale të gjyqtarit – Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për përshkrimin dhe analizën e fakteve, si

të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen ne trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë koncize, të plotë dhe analitike, duke integruar përgjithësisht provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor. Gjithashtu gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen. Sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit lidhur me këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes

Rezulton nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit material dhe procedural në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter civil dhe penal. Evidentohet një kujdes i gjyqtarit për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor. Vlerësoj se aftësia e gjyqtarit në këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Arsyetimi ligjor - 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të tij, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes. Sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi të larta në ndjekjen e një strukture të organizuar të vendimit, ku gjithmonë mendimi është ndarë në paragrafë të numërtuar. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij

rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuara kryesisht nga gjykata, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të cilat janë pjesë e rrethanave të faktit, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata. Sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke i vlerësuar tërësinë e tyre në raport me natyrën e çështjeve, komplekse ose jo, rezulton se gjyqtari ka aftësi mbi mesatare në lidhje me këtë tregues. Konstatohet së vendimet gjyqësore burim vlerësimi, në varësi të kompleksitetit të çështjes dhe pretendimet e palëve, në pjesën analitike të tyre përmbajnë argumenta të lidhura me njëri-tjetrin, duke u ndalur shkurtimisht tek evidentimi i lidhjes shkak-pasojë në raport me konkluzionet për zgjidhjen e çështjes. Përgjithësisht gjyqtari i kushton rëndësi analizimit të pretendimeve të palëve në raport me ligjin që gjen zbatim si dhe me rrethanat konkrete të çështjes, duke i dhënë përgjigje të argumentuar si për çështjet e procedurës ashtu dhe ato për themelin e çështjes. Megjithatë, referuar burimeve të vlerësimit nuk evidentohet e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të analizës dhe argumentit logjik, si në raport me rrethanat e faktit ashtu edhe në raport me pasqyrimin e pretendimeve dhe analizimin e tyre. Sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në këtë tregues “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është mbi mesatare, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.

Si përfundim, propozimi për kriterin e parë “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, e përgjithshmja është niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, 95 pikë.

Aftësitë organizative të gjyqtarit – Aftësitë e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë - 2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda

afateve ligjore. Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (deri në 2 ditë) si dhe zbritet koha gjatë se cilës gjyqtari ka kryer lejen vjetore, atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultojë nga 174 që janë në tejkalim të afatit në 124, me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (807 çështje), rezulton të jetë 15 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor, përqindje që sipas metodologjisë vlerësohet me 12 pikë. Shkalla e aftësisë së gjyqtarit është shumë e lartë, brenda marzhit “11-20 %”, duke e pikëzuar me 12 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve që rezulton të jetë 10.7 %, gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë. Pra vlerësoj se në lidhje me këtë tregues, gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij është tej standardit minimal, është 10.7 %, kurse 11 e lart do të vlerësohej me 4 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Referuar metodologjisë, duke qenë se për shumicën e kategorive të çështjeve, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër se afati procedural, gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues. Pra referuar sa më sipër vlerësoj se në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtari duhet të pikëzohet me 4 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit është 111 %, për këtë arsye gjyqtari duhet të vlerësohet dhe pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues, pasi rezulton me një rendiment + 99 %. Propozimi është për t’u pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve” dhe gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues. Vlerësoj se duhet të pikëzohet m 15 pikë.

Aftësitë për të kryer procedurat gjyqësore - 2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive

Për këtë tregues, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2,25 seanca dhe në çdo rast gjyqtari ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet në nivel maksimal, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka kryer me efincë veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse. Kështu që vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore – 2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes

Rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi. Sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes

Rezulton se gjyqtari ka shkallë mbi mesataren për këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve të që lidhen me çështjen konkrete, përveç mungesës të "Letrës të të drejtave" e cila nuk rezulton të jetë administruar bashkëlidhur kopjes së njoftimeve për seancën e parë gjyqësore për të pandehurin dhe të dëmtuarin nga vepra penale në dosjet penale të përzgjedhura me short për vlerësim. Sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues duhet të vlerësohet mbi mesataren duke e pikëzuar me 8 pikë.

Në përfundim, për këtë kriter "Aftësitë organizative të gjyqtarit", propozoj nivelin e vlerësimit "Shkëlqyeshëm" dhe pikët 94.

Kalojmë tek kriteri i tretë "Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale" – Etika në punë - 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Rezulton nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion. Vlerësoj që shkalla në treguesin "Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion" është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 35 pikë.

Integriteti i gjyqtarit - 3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti

Referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit. Sa më sipër vlerësoj se shkalla e integritetit të gjyqtarit në lidhje me këtë tregues është shumë e lartë dhe pikëzohet me 40 pikë.

Paanësia e gjyqtarit - 3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se

gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese. Propozoj/vlerësoj që duhet pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se numri i kërkesave (vetëm një kërkesë ka pasur) të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe ka pasur vetëm një kërkesë (e thashë) dhe vlerësoj se duhet pikëzuar me 15 pikë.

Si përfundim, për këtë kriter “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” propozimi im është niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm” dhe pikët 100.

Kalojmë tek kriteri i katërt “Aftësitë profesionale dhe angazhimi profesional” – Aftësitë e komunikimit - 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent

Nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm. Sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit lidhur me këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi të larta në drejtim të këtij treguesi. Aftësia është e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Aftësia për të bashkëpunuar - 4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta

Nga të dhënat rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë. Sa më sipër vlerësoj, se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore

Nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë. Sa më sipër duhet pikëzuar me 10 pikë.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale

Rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës dhe jashtë saj, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 14 aktivitete të zhvilluara për 22 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën trevjeçare. Sa më sipër, vlerësoj se pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës është brenda kufijve të kërkuar, duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve

Referuar të dhënave, rezulton që gjyqtari nuk është angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësues apo ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe nuk rezulton të ketë udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional. Sa më sipër, vlerësoj se në lidhje me këtë tregues nuk rezulton angazhim i gjyqtarit dhe për pasojë duhet të pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata

Referuar të dhënave, gjyqtari nuk rezulton që të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera. Sa më sipër, vlerësoj se në këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike

Nga të dhënat, rezulton që gjyqtari nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën e vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Pra përfundimisht, për kriterin e katërt “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” propozoj nivelin e vlerësimit “Shkëlqyeshëm” dhe 91 pikë.

Në përfundim, për të katër kriteret: Aftësitë profesionale të gjyqtarit, 95 pikë, "Shkëlqyeshëm"; Aftësitë organizative të gjyqtarit, 94 pikë, "Shkëlqyeshëm"; Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm"; Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, 91 pikë, "Shkëlqyeshëm" dhe propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit, "Shkëlqyeshëm" me 380 pikë.

Propozime:

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandoj që gjyqtari {...} t’i kushtojë më shumë rëndësi pjesës së strukturës së vendimeve, të argumentit logjik, të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Hado!

Atëherë, nëse kemi ndonjë diskutim përpara se ta kalojmë për votim?

Po zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Atëherë, unë ndaj qëndrim të ndryshëm nga relatori i çështjes lidhur me kriterin e parë të “Aftësive profesionale”. Vlerësoj që gjyqtari për këtë kriter duhet të vlerësohet "Shumë mirë" dhe jo "Shkëlqyeshëm" dhe arsyet do t’i them për secilin nga katër treguesit e vlerësimit apo pesë treguesit e vlerësimit të këtij kriterit të parë.

Dakordësohem për pjesën e vlerësimit të shkallës së aftësisë “Shumë të lartë” për sa i përket “Aftësisë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”. Përgjithësisht, në të gjitha vendimet, faktet evidentohen referuar provave të administruara apo të shqyrtuara nga gjyqtari në seancë gjyqësore. Gjithashtu identifikohet edhe dispozita.

Për sa i përket “Aftësisë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, në vlerësimin tim, shkalla e aftësisë nuk duhet të vlerësohet “Shumë e lartë” por duhet të vlerësohet “Mbi mesatare” sepse ka vendime gjyqësore ku ligji pothuajse nuk gjen interpretim dhe më i dukshëm është në rastin e një vendimi gjyqësor që ka të bëjë me “Uljen e dënimit”. Duket sikur gjyqtari ka aplikuar ulje dënimi pa u mbushur afati 1-vjeçar i vuajtjes së dënimit nga ana e të dënuarit (është vendimi nr. 111, datë 28.06.2019). Referon nenin 63 të ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, por

23

nuk e bën interpretimin e nenit dhe nuk rezulton as arsyeja se pse. Sipas analizës që bën gjyqtari, edhe pse i dënuari nuk e kishte vuajtur, nuk kishin kaluar 12 muaj nga ulja e mëparshme ose nuk i kishte vuajtur 12 muaj ulje dënimi, ai ka aplikuar vuajte dënimi pavarësisht se ka bërë uljen e pjesshme. Në këtë vendim mungon tërësisht mënyra e interpretimit të ligjit.

Nga ana tjetër edhe në disa vendime gjyqësore që bëhet fjalë kur gjyqtari fillon dhe interpreton ligjin, më tepër janë interpretime skematike sesa interpretime që lidhen me çështjen konkrete të cilës atij i shtrohet për zgjidhje. Në vlerësimin tim nuk është në aftësinë maksimale edhe interpretimi i ligjit kur bëhet fjalë për kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake në rastet kur ai duhet të shqyrtojë mjaftueshmërinë e provave, pavlefshmërinë absolute dhe relative të akteve, gjyqtari tejkalon interpretimin e ligjit dhe futet edhe në cilësimin juridik të veprës apo të provueshmërisë së faktit.

Për këtë arsye, duke vlerësuar metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit për sa i përket “Aftësisë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësoj që aftësia e tij duhet të vlerësohet “Mbi mesatare”, referuar edhe vendimeve që citova.

Sa i përket “Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë” vendimet janë të qarta, koncize dhe të kuptueshme.

Ndërsa, për sa i përket “Strukturës së qëndrueshme dhe të mirëorganizuar” nuk e gjejmë në të gjitha vendimet një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar. Po të shohim strukturën e vendimit, disa vendime ndahen në nënpjesë me tituj, disa të tjerë janë vendime në bllok me paragrafë të gjatë të cilët nuk ndajnë linjën e mendimit nga njëri tek tjetri, dhe tek pjesa e strukturës ne gjithmonë vlerësojmë edhe saktësinë lidhur me disponimet e gjykatës. Vihet re që në vendimet e “zgjidhjes së martesave”, detyrimi për ushqim nuk caktohet nga gjyqtari në mënyrë të individualizuar për secilin nga fëmijët por caktohet në bllok, pra një “detyrim në ushqim” në bllok. Nuk individualizohet për secilin nga fëmijët “detyrimi për ushqim”. Prandaj edhe për këtë tregues vlerësoj që aftësia e tij duhet të vlerësohet “Mbi mesatare” dhe jo “Shumë e lartë”, duke e vlerësuar me 8 pikë.

Lidhur me “Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik”, ndaj të njëjtin qëndrim si relatori, megjithëse ajo mund të vlerësohet edhe si mesatare në fakt në këtë rast, referuar shumicës së vendimeve, por unë nuk kam propozim konkret për këtë.

Bazuar në propozimet e mia vlerësoj që për kriterin e parë të “Aftësive profesionale të gjyqtarit”, niveli i vlerësimit duhet të jetë “Shumë mirë” dhe jo “Shkëlqyeshëm”, me pikët përkatëse 88 pikë.

Ndërsa, për sa i përket “Aftësive organizative”, në fakt relatori edhe pse ka evidentuar ngarkesën shumë të madhe në punë të gjyqtarit (dhe në fakt ka qenë një gjyqtar me një rendiment goxha të lartë), nuk ka bërë rritje të pikëve për shkak të analizës logjike, për sa i përket kriterit të “Respektimit të afatit” dhe kriterit të “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”. Pra konkluzioni i relatorit bazohet vetëm në analizë matematikore të të dhënave statistikore. Me këtë volum pune që gjyqtari ka pasur të përcaktuar në raport, gjatë kësaj kohe, ne gjithmonë kemi rritur nga një nivel vlerësimi dhe tejkalimet në fakt kanë qenë relativisht të vogla. Kështu që për kriterin e “Respektimit të afateve ligjore” unë propozoj që nga 12 pikë, gjyqtari të vlerësohet 15 pikë (pra të rritet); dhe për kriterin e “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, nga 4 pikë në 5 pikë, duke mbetur në të njëjtin nivel vlerësimi “Shkëlqyeshëm”, por duke u rritur pikët nga 94 në 98 pikë.

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ndonjë diskutim nga relatori mbi propozimet e zonjës Ukperaj?

Ridvan Hado: Unë i qëndroj propozimeve të mia. Nuk jam dakord me çfarë tha kolegja. Argumentet i keni në material. Për vendimin “uljen e dënimit”, mendoj që ne nuk i hyjmë dot meritës së vendimit (s’jemi gjykata e apelit apo Gjykata e Lartë). Për të tjerat i qëndroj propozimit tim.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Brikena i ke konkrete, se unë ndoshta nuk i mbajta të gjitha.
(Hidhet në votim propozimi i parë i zonjës Ukperaj.)

Ilir Rusi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk miratohet propozimi i parë.)

Naureda Llagami: Kalojmë.

Brikena Ukperaj: Tek Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit propozoj që nga 10 pikë të pikëzohet me 8 pikë, në aftësinë “mbi mesatare”.

Ilir Rusi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk miratohet propozimi i dytë.)

Naureda Llagami: Tjetër?

Brikena Ukperaj: Në analizë matematikore dhe logjike të të dhënave statistikore (2.A.a Respektimi i afateve ligjore) jo 12 pikë por 15 pikë. (pa mikrofon).

Naureda Llagami: Po!

Ilir Rusi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Kundër.

Atëherë miratohet.

Naureda Llagami: Kalojmë tek “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”.

Brikena Ukperaj: Pikëzimi nga 4 pikë në 5 pikë, të konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë në afatin standard për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Ilir Rusi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Kundër.

Atëherë, kalon edhe kjo.

Kemi nga 94 pikë në 98 pikë, kalon kriteri i dytë. Ndërkohë që nuk kemi ndryshim të kriterit të parë.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim në tërësi të projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër sepse mendoj që niveli i vlerësimit të gjyqtarit duhet të jetë “Shumë mirë”.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjithsej tashmë nga 380 pikë, në 388 pikë (*lapsus, pasi është 384 pikë në total*).

* * *

(Pika 3 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.07.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}”, (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Fatmira Luli**, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Irena Plaku**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EËMI).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}”, (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti tjetër që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Projektraporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarit {...} për periudhën e vlerësimit 2013-2016 është hartuar pas dërgimit nga organet e rivlerësimit kalimtar të dosjes profesionale të gjyqtarit.

Në pjesën e parë shpjegohet procedura e ndjekur. Në pjesën e dytë shpjegohen burimet e vlerësimit, ku si burime, veç atyre të cituara, në mënyrë specifike po ndalem tek të dhënat e burimeve arkivore të KLD-së dhe KLGJ-së. Ka pasur një çështje nga ato të verifikuara që i është adresuar gjyqtarit ose është rekomanduar për t’u marrë parasysh për efekt të vlerësimit etik dhe profesional, por më pas nga ana e inspektorëve është

30

arritur në konkluzionin që në fakt çështja nuk ka qenë e zvarritur sepse afati i gjykimit nga momenti i caktimit të çështjeve në short ka qenë brenda afatit të përcaktuar. Gjithsesi, të gjitha rezultatet e burimeve arkivore janë marrë parasysht nga ana ime si relatore në përcaktimin e shkallës së aftësisë dhe pikëzimit të propozuar për gjyqtarin.

Pjesa tjetër e projektraportit përbëhet nga përshkrimi i dosjeve e cila nuk gjendet në raportin analitik.

Lidhur me “Aftësinë profesionale të gjyqtarit”, për treguesin e “Njohurive ligjore”, 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave

Në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Evidentohet se gjyqtari i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik, fakt ky që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre por, në përputhje dhe në mënyrë të integruar me provat e administruara gjatë gjykimit. Në vendimet penale, tregohet kujdes i posaçëm i gjyqtarit për të përshkruar faktin penal sikurse ai ka rezultuar i provuar në gjykim, nga tërësia e provave të administruara. Në një rast, evidentohet kujdesi i gjyqtarit që pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e prokurorisë, të bëjë një përcaktim të ndryshëm të faktit penal, në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale.

Në drejtim të identifikimit të natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtari përcakton qartë natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, e cila orienton më pas ndërtimin e një strukture specifike në arsyetimin e vendimeve.

Për sa i përket përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në të gjitha vendimet, duke i ndarë ato në dy kategori (vendime civile-familjare dhe vendime penale), bëhet identifikimi i ligjit të zbatueshëm material por edhe ai procedural i cili evidentohet në rastet kur kërkohet që t’i jepet zgjidhje pretendimeve të palëve apo situatave të caktuara procedurale.

Në projektraport gjenden të gjitha dispozitat e ligjit material dhe atij procedural të referuar dhe të cituar nga ana e gjyqtarit në vendimet e veta.

Për sa i përket konfliktit të normave, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga

gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave, për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive materiale në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Për këtë arsye është propozuar shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi me 25 pikë.

Për sa i përket “Aftësisë së gjyqtarit për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”.

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës procedurale dhe materiale civile apo penale, si ligji i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore materiale citohen ose referohen, duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile ose të çështjes penale objekt shqyrtimi. I njëjti kujdes i gjyqtarit nuk evidentohet në rastin e interpretimit të dispozitave procedurale civile, kur ato janë drejtpërdrejt të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes. Mungesa e kompleksitetit të çështjeve referuar natyrës së mosmarrëveshjeve civile, jo gjithmonë justifikon mungesën e arsytimit të dispozitës procedurale.

Sa i përket interpretimit të ligjit material, sipas natyrës së vendimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast interpreton dispozitat respektive të zbatueshme dhe interpretimin e bën në mënyrë të pavarur. Në vendimet penale dhe ato civile dispozitat materiale të zbatueshme, interpretohen para se ato të aplikohen mbi faktet e provuara, duke u zbërthyer në elementët e tyre përbërës duke evidentuar edhe qëllimin që ka dispozita.

Në projektraport gjeni të pasqyruar mënyrën e interpretimit të ligjit në vendimet civile dhe në vendimet penale.

Ndërsa në drejtim të interpretimit të ligjit procedural, nga tërësia e burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari i ka kushtuar rëndësi interpretimit të disa dispozitave procedurale që zbatohen mbi rrethanat procedurale, duke u ndalur vetëm në disa raste

në interpretimin teorik të tyre dhe në shumicën e rasteve në aplikimin e drejtpërdrejtë të tyre mbi faktet e çështjes.

Në vendimet civile të analizuara, sa i përket ligjit procedural kur ai është drejtpërdrejt i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, konkretisht referuar vendimit civil nr.68, datë 05.03.2014, përmbajtja e normave, neneve 32/c dhe 253 dhe 254 të K.Pr.Civile, citohet në vendim, pa u bërë interpretim i tyre më vete dhe sistematik me njëra-tjetrën. Në vendim nuk analizohen kushtet e zbatimit të nenit 32/c të K.Pr.Civile përballë ekzistencës së akteve zyrtare me fuqi të plotë provuese. Kjo mungesë interpretimi e bën të paqartë në vijim, mënyrën se si këto dispozita janë bërë të zbatueshme mbi faktet e provuara në gjykim. Mungesa e interpretimit në këtë rast nuk është kushtëzuar nga objekti i mosmarrëveshjes së trajtuar, përkundrazi ka qenë i nevojshëm, për të kuptuar deduksionin logjik të përdorur në konkluzionin e arritur për zgjidhjen e çështjes.

Lidhur me jurisprudencën relevante, përdoret nga gjyqtari në mënyrë konsistente vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, referuar instituteve apo natyrave të veprave penale për të cilat të pandehurit janë deklaruar fajtorë.

Gjithashtu edhe lidhur me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve, gjyqtari njih dhe zbaton parimet e përgjithshme procedurale dhe materiale, të cituara në mënyrë më të hollësishme në raportin e vlerësimit.

Si konkluzion për këtë tregues, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari i ka kushtuar rëndësi interpretimit të ligjit material, zbatimit të praktikës gjyqësore unifikuese, praktikës gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, zbatimit të parimeve të përgjithshme të së drejtës, por jo me të njëjtën shkallë maksimale kujdesi, interpretimit të dispozitave procedurale civile, kur ato janë drejtpërdrejt të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes. Në këtë rast të fundit, mungesa e zbërthimit të normave procedurale nëpërmjet interpretimit, nuk arrin të tregojë lidhshmërinë e tyre me faktet e çështjes. Për këtë arsye kam propozuar që për këtë tregues të vlerësohet mbi mesatare duke u pikëzuar me 20 pikë.

Për sa i përket “Qartësisë dhe kuptueshmërisë, koncizitetit të vendimit”, në të gjitha burimet e vlerësimit që janë dokumentet ligjore, vendimet gjyqësore, rezulton se

gjqytari ka aftësi shumë të mira në drejtim të këtij treguesi dhe është pikëzuar me 15 pikë.

“Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” – në tërësi, referuar të dhënave rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, jo vetëm në aspektin vizual por edhe atë përmbajtësor të dokumentit ligjor. Nga ana tjetër, ndarja në pjesë, sipas përmbajtjes dhe ndarja e tyre në paragrafë të cilët kanë gjatësi mesatare dhe përmbajnë analizën e një elementi të caktuar të arsytimit, e bën strukturën e vendimit funksionale dhe i jep lehtësi në lexim dhe kuptueshmëri, favorizuar kjo edhe nga natyra jo komplekse e çështjeve të analizuara. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 10 pikë. Aftësi shumë e lartë e gjyqtarit.

Për sa i përket “Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik” i cili është treguesi i fundit, i kriterit të parë, referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se përgjithësisht, gjyqtari paraqet një analizë të strukturuar të fakteve të çështjes, identifikon, citon dhe analizon ligjin e zbatueshëm, e aplikon atë mbi faktet e çështjes dhe pasqyron argumentet mbi mënyrën e zbatimit të ligjit, duke lidhur këto argumente me konkluzionet e arritura mbi kërkimet objekt padie, pretendimet e palëve, apo konkluzionin e tij mbi çështjet penale të shqyrtuara.

Kryesisht, në vendimet penale të themelit, gjyqtari i kushton një vëmendje më të posaçme arsytimit të vendimeve, dhënies së argumenteve ligjore të plota lidhur me faktin penal objekt akuze, provueshmërinë e tij, cilësimin ligjor të faktit, si dhe autorësinë e të pandehurit. Në vendimet civile, cilësia e arsytimit dhe niveli i argumentimit logjik janë më të dukshme në disa prej vendimeve, kryesisht në vendimet që lidhen me marrëdhëniet e punës dhe çështjet familjare, ndërsa në vendimet e tjera arsytimi përqendrohet kryesisht në paraqitjen dhe analizën e rrethanave të provuara në gjykim, në raport me kërkimin objekt padie, pa u ndalur në mënyrë të posaçme në dhënien e argumenteve të zgjeruara ligjore mbi mënyrën e aplikimit të ligjit mbi faktet konkrete. Megjithatë, cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik në një pjesë të vendimeve të analizuara, kryesisht disa prej vendimeve civile dhe penale, është e kushtëzuar edhe nga natyra e mosmarrëveshjes dhe çështjes penale në shqyrtim, e cila në këto raste ka natyrë

të thjeshtë, duke kufizuar nevojën e kryerjes së një analize të zgjeruar ligjore mbi faktet e provuara.

Nëse argumentimin logjik të analizës do ta ndanim në dy pjesë, në procesin analitik të të provuarit të fakteve dhe atë logjik se si konceptet, institutet dhe dispozitat zbatohen në një situatë të caktuar të provuar, i pari mbizotëron në analizën e gjyqtarit. Peshën kryesore në vendimet gjyqësore të analizuara e zë kryesisht procesi analitik i të provuarit të fakteve dhe ai i interpretimit abstrakt të normës materiale. E njëjta shkallë aftësie nuk evidentohet në analizën e zbatimit të ligjit mbi faktet e provuara. Madje në disa raste, konkluzioni vjen menjëherë pas evidentimit të faktit dhe interpretimit abstrakt të elementëve të dispozitës. Kjo mënyrë e të shkruarit dhe të arsyetuarit, jo gjithmonë evidenton nëse faktet konkrete të çështjes janë të asaj natyre, cilësie (kualiteti) dhe të tilla që kërkohet nga dispozitat e ligjit material apo atij procedural, në lidhje të drejtpërdrejtë me konkluzionin e arritur. Për këtë arsye kam propozuar shkallë aftësie “mbi mesatare” duke u pikëzuar me 20 pikë.

Duke qenë se i dhamë fund kriterit të parë, gjyqtari ka bërë kundërshtime lidhur me dy tregues të këtij kriteri. Kundërshtimi i parë është në lidhje me kriterin e vlerësimit “Mbi aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”. Nuk ka dhënë ndonjë argument shtesë por ka ripërsëritur atë që ai ka pas shkruar edhe në formularin e aftësive profesionale ku thuhet: “Për këtë tregues vlerësimi çmoj se kam aftësi shumë të lartë për të indentifikuar ligjin e aplikueshëm dhe arsyetimin e tij për mënyrën e zbatimit mbi faktet objekt gjykimi. Krahas identifikimit të ligjit të aplikueshëm, çmoj se kam aftësi shumë të lartë për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës, etj.” Pra është një vetëvlerësim që gjyqtari i bën vetes, jo se ka ndonjë argument tjetër nga gjetjet që janë bërë në këtë projektraport vlerësimi.

E njëjta gjë mund të themi edhe për treguesin e “Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik”, vetëvlerësim që gjyqtari i bën vetes është që kjo duhet të jetë në një shkallë shumë të lartë dhe jo “mbi mesatare”.

Përfundimisht, për kriterin e parë të “Aftësive profesionale”, shkalla e aftësisë propozohet “Shkëlqyeshëm” dhe pikët 90.

Për sa i përket “Aftësive organizative të gjyqtarit”, 2.A.a. Respektimi i afateve

ligjore. Nga burimet e vlerësimit nuk evidentohet asnjë çështje e shqyrtuar jashtë afatit – 15 pikë.

Për sa i përket 2.A.b. Plotësimi i standardeve minimale kohore, duke iu referuar të gjitha burimeve të vlerësimit, vendimeve gjyqësore pjesë të dosjes, vendimet e përzgjedhura me short, vendimet e administruara për shkak të verifikimit të ankesave dhe atyre të trajtuara (përmendur në relacionin e ish-KLD-së), ka rezultuar se janë vetëm 12.5% të çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit standard minimal kohor, përqindje e cila vetëm në analizë matematikore sipas metodologjisë përkon me nivelin e vlerësimit 4 pikë.

Ndërkohë, duke analizuar shkaqet, çështjet të cilat nuk mund të jenë përgjegjësi e gjyqtarit, referuar çështjes civile nr. {...}, 11.06.2014, vendimi nr.{...}, 08.10.2015, nëse do të bëhet edhe një herë një rillogaritje matematikore për 16 çështje, rezulton që vetëm 6.25% e tyre janë shqyrtuar jashtë afatit standard. Në rastin e parë është përjashtuar çështja ku vonesa ka ardhur për shkak të lejes vjetore dhe në rastin e dytë tejkalmi ka qenë me 268 ditë dhe nuk është përjashtuar nga analiza matematikore. Pra duke iu referuar përqindjes 6.25% që është brenda frekuencës 0-10, është propozuar pikëzimi me 5 pikë dhe nuk ka pasur nevojë për ngritje të pikëve për shkak të analizës logjike të të dhënave.

Për sa i përket 2.a.c. Koha mesatare, ka rezultuar më e shkurtër se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve. Pikëzimi me 5 pikë.

Për sa i përket 2.a.ç. Rendimentit të përfundimit të çështjeve, referuar edhe rendimentit të përcaktuar edhe në raportin ndihmës për organet e rivlerësimit, ai ka rezultuar në masën 93.4%. Pikëzimi me 8 pikë. Nuk është propozuar rritja me një shkallë për shkak se nuk ka tejkalmuar me më shumë se 50% standardin minimal të ngarkesës. Pikëzimi me 8 pikë. Gjyqtari nuk e ka kundërshtuar. Këtë vlerësim.

2.a.d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit, rezulton “Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve”. Është tejkalmuar vetëm për një nga kategoritë me 3.2 ditë i cili është konsideruar një tejkalmim i papërfillshëm, duke pasur në konsideratë se nuk tejkalohej afati 15-ditor i të drejtës së ankimit.

Gjithashtu për sa i përket Numrit mesatar të seancave për çdo çështje dhe i kryerjes së veprimeve procedurale ka rezultuar që numri total i seancave është 2.5

seanca për të gjitha kategoritë e çështjeve dhe përgjithësisht gjyqtari kryen me efektivitet dhe produktivitet të gjithë procesin gjatë seancave gjyqësore të vëzhguara, për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 15 pikë.

2.b.b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, të gjitha i përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtarë. Në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore brenda 3 ose deri në 15 ditë pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile dhe penale. Thuhet në përgjithësi pasi në një rast gjyqtari vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, e ka marrë jashtë afatit 10-ditor. Megjithatë është një rast që nuk peshon në vlerësimin e gjyqtarit. Seancat përgatitore dhe ato gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës, duke u mbajtur me sistemin e regjistrimit audio, si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Në çështjet civile- Përgjithësisht seancat gjyqësore të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe çdo veprim tjetër procedural që gjyqtari kryen gjatë procesit gjyqësor. Është përdorur termi përgjithësisht pasi në një rast evidentohet se gjyqtari pas ezaurimit të veprimeve përgatitore dhe kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, ka vijuar gjykimin pa njoftuar palën e paditur për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe datën e kësaj të fundit, duke vijuar gjykimi në mungesë, për shkak të deklaramit të mungesës në seancë përgatitore, edhe pse në referim të neneve 175 dhe 179 të K.Pr.Civile gjykata ka detyrimin për të njoftuar palët për seancën gjyqësore dhe të hetojë shkaqet e mosparaqitjes së tyre. Nga ana tjetër në këtë rast nuk rezulton që vendimi i ndërmjetëm i marrë në seancë përgatitore të jetë i arsyetuar pse gjyqtari nuk ka urdhëruar njoftimin për seancën e parë gjyqësore të palës së paditur në mungesë.

Ndërsa në çështjen familjare me objekt “Zgjidhje martesë” rezulton se me vendimin për “Kalimin e çështjes në seancë gjyqësore”, gjyqtari ka caktuar seancën gjyqësore në datën 09.07.2014. Dy seancat e para të zhvilluara në datat 11.09.2014 dhe 02.10.2014, edhe pse në procesverbal evidentohen se janë seanca gjyqësore, nga

përmbajtja e tyre dhe shkak i shtyrjes së seancave rezulton të jenë kryer në kuadër të përpjekjeve të gjykatës për pajtim, sipas nenit 134 të K.Familjes. Edhe pse nga përmbajtja e shënimeve të bëra në fletëthirrjen drejtuar të paditurit në adresën e tij sipas akteve të gjendjes civile rezulton shënimi “nuk ndodhet në shtëpi”, gjyqtari nuk rezulton të ketë proceduar me njoftimin për afishimin publik parashikuar nga neni 133 i K.Pr.Civile në fuqi në kohën e gjykimit. Për seancën e parë efektive të pajtimit, i padituri rezulton i njoftuar nëpërmjet marrjes përsipër të njoftimit nga vëllai i njoftuar me telefon celular, i cili edhe pse ka deklaruar se nuk ka folur prej kohësh me të vëllain ka marrë përsipër njoftimin. Ky njoftim i referohet seancës së parë të pajtimit. Në vijim gjyqtari ka marrë vendimin për caktimin e një seance të dytë pajtimi, duke urdhëruar përsëritjen e njoftimit për palën, por edhe pse njoftimi është kthyer përsëri me shënimin “nuk ndodhet në shtëpi” i firmosur nga një dëshmitar, që nga shënimi duket se është i vëllai i të paditurit, po nga gjyqtari ka vazhduar seancën përgatitore në mungesë duke vazhduar edhe atë gjyqësore në mungesë edhe pse akti i njoftimit nuk përmban të gjithë elementët e parashikuar nga neni 131 paragrafi 4 i K.Pr.Civile. Ky rast në fakt i është evidentuar gjyqtarit edhe në raportin analitik të përgatitur në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Lidhur me dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me disa vonesa me 15 minuta që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Pavarësisht fillimit me vonesë të disa prej tyre, janë në një përqindje të vogël seancat (11% e seancave rezultojnë të filluara me vonesë) ku vetëm në një rast fillimi i vonesës ka sjellë pasoja në produktivitetin e gjykimit për shkak të fillimit me vonesë është shtyrë seanca gjyqësore.

Përfundimisht, duke iu referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë aftësie “mbi mesataren” në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizmin e procesit gjyqësor”, aftësi të cilat reflektohen në mënyrë më të plotë në disa prej çështjeve të analizuara, duke ndjekur me korrektësi planifikimin, mbikëqyrjen, zhvillimin dhe dokumentimin e veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil në seancat gjyqësore të

zhvilluara, ndërkohë që në dy dosjet e analizuara më lart gjyqtari nuk reflekton të njëjtën shkallë kujdesi lidhur me njoftimin efektiv të palës së paditur për pjesëmarrje në seancë pajtimi apo zhvillimin e seancës gjyqësore. Gjyqtari nuk ka mbikëqyrur në çdo rast plotësinë dhe qartësinë e njoftimit për palët që iu drejtohen, pavarësisht masave të tjera efektive të marra prej tij për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Përfundimi i gjykimit në një kohë sa më të shpejtë, nuk justifikon shmangien e detyrimeve procedurale për njoftimin e rregullt të palëve në proceset civile. Për këtë arsye kam vlerësuar që për këtë kriter shkalla e aftësisë së tij duhet të vlerësohet mbi mesatare duke u pikëzuar me 16 pikë.

Edhe për këtë tregues gjyqtari ka bërë kundërshtime. Nuk ka paraqitur argumente apo prova shtesë lidhur me gjetjet për këtë tregues, por thjesht ka vetëvlerësuar veten duke shprehur se gëzon aftësi shumë të lartë për të qenë efektiv në kryerjen e veprimeve procedurale, kryerjen e veprimeve përgatitore, njoftimin e deklaratës së mbrojtjes, dokumentimin e veprimeve, drejtimin e procesit, duke orientuar drejt debatin, fillimin e seancave, regjistrimin audio të tyre, ndjekjen me rigorozitet të fazave të cilat kalojnë proceset gjyqësore apo orientimin e palëve për zgjidhjen e rrugës alternative. - Nuk evidentohet kjo zgjidhja e rrugës alternative. Ndoshta nuk spikat në këto dosjet e përzgjedhura me short.

Për sa i përket “Aftësisë së gjyqtarit për të administruar dosjen”- Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes, renditja e akteve në dosje përgjithësisht është e njëjtë, e bërë në mënyrë të tillë që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme dhe propozohet pikëzimi me 5 pikë, shkallë shumë e lartë aftësie.

Për sa i përket “Saktësisë dhe plotësisë”, edhe këtu përgjithësisht nuk konstatohet mungesë dokumentacioni apo prania e akteve që nuk i përkasin çështjes konkrete, me përjashtim të një çështjeje civile (janë evidentuar ekstremitetet e çështjes), ku konstatohet mungesa e vendimit të zbardhur të refuzimit të marrjes pjesë në gjykim të personit të tretë. Nga përmbajtja e vendimit dhe procesverbalit të seancës përgatitore konstatohet se gjyqtari ka refuzuar pjesëmarrjen në gjykim të personit të tretë të thirrur nga pala paditëse në padi, por nuk rezulton të jetë zbardhur i arsyetuar dhe të jetë pjesë e akteve të dosjes vendimi i refuzimit të marrjes pjesë të personit të tretë, ndaj të cilit në zbatim të nenit 194 paragrafi 2 të K.Pr.Civile në fuqi në kohën e gjykimit, lejohet ankimi i veçantë. Pra

gjqytari nuk e ka zbardhur vendimin, i cili vendimi nuk është pjesë e dosjes. Nuk ka sjellë kundërshtime në lidhje me këtë gjetje. Për këtë arsye kam vlerësuar që shkalla e aftësisë për këtë tregues duhet të jetë mbi mesatare duke u pikëzuar me 8 pikë.

Për kriterin e dytë të aftësive organizative propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 92.

Për sa i përket "Etikës në punë", "Integritetit", "Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese", dhe "Numrit tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit", nuk ka pasur të dhëna apo gjetje të cilat do të ndikonin në një pikëzim të ndryshëm nga ai maksimal. Nuk ka pasur të dhëna për masa disiplinore. Për këtë arsye, për të gjithë treguesit e këtij kriteri është propozuar pikëzimi maksimal dhe në përfundim të tyre, niveli i vlerësimit për kriterin e etikës është "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Tek "Aftësitë personale dhe angazhimi profesional" – "Aftësitë e komunikimit", "Komunikimi i qartë dhe transparent", "Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale", "Aftësia për të bashkëpunuar", "Shkalla e bashkëpunimit dhe komunikimit me kolegët duke përfshirë edhe shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta", "Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore", janë vlerësuar maksimalisht. Nuk ka pasur të dhëna të cilat mund të afektonin një pikëzim të ndryshëm.

Lidhur me "Pjesëmarrjen në veprimtari trajnuese gjatë Shkollës së Magjistraturës", rezulton që për të gjithë periudhën 3-vjeçare ka marrë pjesë në 12 aktivitete të zhvilluara (23 ditë trajnimi). Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 20 pikë.

Nuk rezulton të ketë kontribuar lidhur në udhëheqjen e gjyqtarëve gjatë stazhit profesional apo për trajnimin e tyre. Pikëzimi me 3 pikë.

Nuk ka të dhëna për veprimtari ndërinstitucionale që ndikojnë në përmirësimin e drejtësisë, dhe veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata. Pikëzimi me 3 pikë.

Publikimet ligjore akademike, nuk ka të dhëna. Pikëzimi 0 pikë.

Përfundimisht për kriterin e katërt të "Aftësive personale dhe angazhimit profesional", pikëzimi propozohet të jetë 91 pikë.

Përfundimisht, për të katër nivelet e vlerësimit, në cilësinë e relatores kam propozuar që për “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, niveli i vlerësimit të jetë "Shkëlqyeshëm", pikët 90.

“Për aftësitë organizative të gjyqtarit”, niveli i vlerësimit të jetë "Shkëlqyeshëm", pikët 92.

Për “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, niveli i vlerësimit të jetë "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", me 91 pikë.

Përfundimisht, për vlerësimin e përgjithshëm propozoj nivelin e vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 373.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi diskutim?

Marçela Shehu: Faleminderit!

Unë përgjithësisht jam dakord me ato që parashtrori relatorja dhe me konkluzionet. Kam vetëm një mendim ndryshe dhe një propozim për një nga treguesit, konkretisht për “Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik”. Ndryshe nga sa propozohet, unë vlerësoj që lidhur me këtë tregues, gjyqtari duhet të vlerësohet me 25 pikë (pra nga 20 në 25 pikë). Ky është propozimi im i vetëm.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Nga ana e relatores kemi...?

Jo!

Kalojmë pra në votim, në qoftë se s’kemi diskutime të tjera, hedhim në votim propozimin fillimisht të zonjës Shehu dhe pastaj të relatores.

Ilir Rusi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Kundër.

Atëherë, kalon propozimi i zonjës Shehu.

Hedhim në tërësi të gjithë raportin.

Ilir Rusi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet raporti për vlerësimin etik dhe profesional me qëllim gradimi të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, duke e vlerësuar atë si më poshtë

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 4 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.07.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Marçela Shehu* (anëtare)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktet e radhës që kanë të bëjnë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e shpallur me vendimin nr.23, datë 18.01.2023”. Do të raportohet nga zoti Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Më lejoni ta paraqes në mënyrë të sintetizuar relacionin, pasi është përgatitur dhe keni pasur kohë të mjaftueshme për ta kuptuar atë.

Në kuadër të përpjekjeve që ka bërë KLGJ-ja në konstatimin e vakancave në nivele të ndryshme në sistemin gjyqësor, ka aplikuar instrumentet ligjorë përkatëse. Një nga institucionet në të cilin janë konstatuar vakanca ka qenë edhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për të cilën nga ana e Këshillit kanë filluar procedurat e lëvizjes paralele. Për pozicionin e shpallur me vendimin nr.23, datë 18.01.2023 të KLGJ-së, një nga kandidatet është edhe zonja {...}, aktualisht gjyqtare e transferuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Për këtë shkak kanë filluar procedurat e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele me vendimin nr. 295, datë 30.05.2023. Në kuadër të qenit relator për këtë pozicion, nga ana ime janë administruar të gjithë aktet e nevojshme që provonin plotësimin e kritereve ligjore të kandidimit. Kështu në këtë kuadër janë administruar nga burimet njerëzore të dhënat e duhura nga ku rezulton që me dekretin {...}, datë 31.10.2014 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. {...}, datë 23.06.2016 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme pasi kjo gjykate nuk ka pasur ndarje dhomash. Qe prej datës 20.10.2020 ka ushtruar funksionin e Zëvendëskryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të gjyqtarëve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, në datën 09.10.2020 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Me vendim nr. 219, datë 28.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 8 vite. Znj. {...} nuk konstatohet të ketë masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, nga verifikimet e kryera, rezulton se pranë Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Përmet, për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtareve, nuk ka pasur ndarje në seksione/trupa gjykses. Në lidhje me gjyqtaren {...} vitin e fundit 2022 ka qenë me leje lindje. Nga verifikimet e kryera, rezulton se kandidatja: për periudhën 2018 – qershor

2022 ka gjykuar në total 901 çështje, nga të cilat 270 çështje civile dhe 271 kërkesa civile.

Nga të dhënat rezultojnë se deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 23 datë 18.01.2023, zonja {...} ka mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Gjithashtu u administruan dhe u verifikua nëse ka kritere ndaluese të parashikuara nga dispozitat e nenit 8/3, 48/8 e ligjit “Për statusin”. Nuk u konstatua të ketë dokumentacion i cili të provonte ekzistencën e një mase disiplinore në fuqi apo zonja {...} të ketë papajtueshmëri ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në këtë kuadër, nga ana e relatorit u përgatit projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ilir Rusi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatori.

* * *

(Pika 5 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.07.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, dhe përfundimin e procedurës për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”/ “Për skualifikimin e kandidatit {...} në procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, dhe përfundimin e procedurës për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Dritan Hallunaj*** (anëtar)

5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Marçela Shehu* (anëtare)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthë.*
3. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EEMI).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, dhe përfundimin e procedurës për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”/ “Për skualifikimin e kandidatit {...} në procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, dhe përfundimin e procedurës për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktet e radhës që ka të bëjë me kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Parashtroj relacionin për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjes paralele të z. {...}.

Me vendimet nr. nr.11 – nr.24, datë 18.01.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosur hapjen e katërbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 11 deri nr. 20, datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe me vendimet nr. 21 deri nr.24, datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira nr. 22 dhe nr. 23, datë 18.01.2023 kandidoi edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati) gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, mbështetur në vendimet 22/2023 dhe 23/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

Me vendimin nr.295, datë 30.05.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve, Këshilli ka vendosur:

Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve si dhe caktimin e relatorit.

Pasi është njoftuar kandidati në rrugë elektronike dhe nuk ka paraqitur ndonjë pretendim në lidhje me relatorin apo ndonjë anëtar të Këshillit, është vijuar me përpunimin e të dhënave duke i kërkuar informacion të nevojshëm Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjes personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

Për verifikimin e kritereve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me komunikimin elektronik datë 31.05.2023, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës për kandidatin z. {...}, si më poshtë.

Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ai ka kandiduar, ku ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, me anë të shkresës nr. {...} prot., datë 01.06.2023, informacioni u kërkua në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Kjo e fundit ktheu përgjigje me shkresën nr.{...} prot., datë 05.06.2023, protokolluar më datë 12.06.2023.

Më datë 09.06.2023 kandidati z. {...}, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 23, datë 18.01.2023, në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., datë 09.06.2023, duke parashtruar se:...”Deklaroj se heq dorë nga aplikimi për lëvizjen paralele në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor...”. Sa më sipër referuar, verifikimi lidhur me kriteret ligjore u zhvillua vetëm për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023.

Rezultatet e verifikimit.

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale specifike minimale”. Sipas pikës 6, të nenit 43 të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”.

Nga informacionin e paraqitur nga ana e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datën 20.07.2011, dhe ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2013. Në vijim ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018. Me vendim nr. 130, datë 19.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendim nr. 153, datë

30.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite. Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në këtë kuadër, nga të dhënat rezulton që nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit nga kandidati zoti {...} deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 22, datë 18.01.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit të kandidimit.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit nga ana nga e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, meqenëse kandidati është emëruar me vendimin nr. 130, datë 19.07.2019, plotëson kriterin pra të ketë mbi 1 vit përvojë profesionale specifike si gjyqtar në fushën e të drejtës civile gjatë 3 viteve të fundit.

Gjithashtu është verifikuar kriteri i mospasjes masë disiplinore në fuqi dhe rezulton nga informacioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi. Dhe kriteri i papajtueshmërisë ambientale, ku nga dokumentacioni rezulton që nuk vërtetohet që të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast transferimi nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Nga ana e Komisionit është dërguar me dy variante por kur është dërguar kjo është dërguar përpara vendimmarrjes nga ana e Këshillit, ku kjo pjesë është ezauruar. Kështu që të mos konsiderohet pjesa tjetër (varianti i dytë), por vetëm varianti i parë i cili është edhe propozimi i Komisionit.

Ky Komision vlerëson kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse s'kemi diskutim, vazhdojmë me votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të relatorit lidhur me kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile.

* * *

(Pika 6 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.07.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e mjeteve të transportit (autovetura dhe motoçikleta), në disa gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Fatmira Luli**, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Irena Plaku**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e mjeteve të transportit (autovetura dhe motoçikleta), në disa gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Aktet në vijim në fakt janë akte që vijnë nga Komisioni i Administrimit të Buxhetit.

Në kuadër të hartës kemi rishpërndarjen e mjeteve të transportit që u mbledhën për shkak të ristrukturimit të gjykatave të shkallëve të para, duke parë dhe nevojat, kemi bërë një shpërndarje të këtyre mjeteve. Në fakt do ju vijë edhe shpërndarja për gjykatat administrative që nga ana e Komisionit është bërë akti dhe do jua përcjellim shumë shpejt. Kjo është thjesht një shpërndarje që ne kemi bërë në bazë nevoje, duke bërë edhe vlerësimin e automjeteve. Kuptohet, një pjesë e automjeteve janë për jashtë shërbimi, por kjo gjë duhet bërë nga gjykata përkatëse, që të bëjë vlerësimin dhe ta nxjerri jashtë shërbimi. Por aktualisht ne duhet që si asete t’i kalojmë tek këto gjykata.

Shkurtimisht, keni tabelën. Në qoftë se keni ndonjë merak, ndonjë pyetje. Komisioni është këtu. Drejtorin përkatës e kemi këtu. Pra bëhet fjalë që një pjesë janë të amortizuara dhe do të kalojnë thjesht që të vijohen procedurat e daljes, ndërsa pjesa

tjetër ia kemi kaluar atyre gjykatave që kanë qenë më shumë në nevojë, përfshirë këtu edhe mjetin tjetër që janë motoçikleta.

Në qoftë se s'keni diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Illir Rusi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet rishpërndarja e mjeteve të transportit në disa gjykata, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 7 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.07.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve, në disa gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Fatmira Luli**, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Irena Plaku**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve, në disa gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Akti i dytë ka të bëjë me miratimin për nxjerrje nga përdorimi të disa aktiveve në disa gjykata.

Për këtë gjë do të ftoja drejtorin që ta shpjegojë me termat e tij.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor tashmë është procedurë e njohur depozitimi i kërkesave të disa gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të disa gjykatave administrative të shkallës së parë, sigurisht që kanë pasur pak kohë kur këto ishin funksionale se tashmë ka përfunduar ristrukturimi, kanë paraqitur kërkesa për miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve, pjesë e inventarit të tyre, që ka rezultuar si më poshtë:

Pajisje elektronike, pajisje zyre, pajisje sigurie, pajisje të tjera dhe disa automjete.

Gjykatat të cilat kanë paraqitur kërkesa për miratimin e nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve, janë: Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Kurbin, Pukë, Pogradec, Vlorë, Tiranë, Shkodër dhe Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Durrës dhe Vlorë. Të gjitha kanë paraqitur dokumentacionin pranë KLGJ-së i cili është verifikuar nga struktura përgjegjëse Drejtoria e Investimeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor për Administrimin dhe Menaxhimin e Aktiveve dhe në përfundim të verifikimit, të administrimit, vlerësimit të të gjithë dokumentacionit të ardhur nga gjykatat është konstatuar se ato i kanë zbatuar të gjitha kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin për menaxhimin e aseteve në fuqi në sektorin publik.

Për sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozon seancën plenare të Këshillit, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve për të gjitha gjykatat e sipërcituara, si dhe të evidentuara në mënyrë analitike sipas pasqyrave nga nr. 1 deri në pasqyrën nr.19, bashkëlidhur relacionit, që besoj të gjithë jeni njohur.

Naureda Llagami: Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 8 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.07.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi dhe transferimin pa pagesë të serverit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi dhe transferimin pa pagesë të serverit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë edhe tek projekt-akti tjetër.

Edhe kjo ka të bëjë me nxjerrjen nga përdorimi dhe transferimi pa pagesë të serverit në pronësi të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër tek Gjykata Administrative e Lushnjës.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Nisur nga nevoja e funksionimit dhe nevojës së Gjykatës Administrative të Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnjë u bë e mundur evidentimi i serverit që ishte blerë vjet Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër dhe e cila nuk ishte vënë në funksionim, kështu që Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe i IT-së përgatiti memon përkatëse duke kaluar të gjithë instancat në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe

duke bërë propozimin për transferimin kapital pa pagesë të këtij aseti nga Gjykata Administrative e Shkalles së Parë Gjirokastrë, në Gjykatën Administrative të Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnjë. Qëllimi kryesor i saj është vënia në funksionim i serverit pranë Gjykatës Administrative të Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnjë, që është një mjet i domosdoshëm për fillimin e funksionimit të saj në datën 1 korrik.

Për sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozon seancës plenare të Këshillit, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit për nxjerrje nga përdorimi dhe transferimin pa pagesë të serverit të Gjykatës Administrative Gjirokastrë, për tek Gjykata Administrative e Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnjë.

Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 9 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.07.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përditësimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2021 – 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 4. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 5. Alban Toro | (anëtar) |
| 6. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Fatmira Luli***, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Irena Plaku***.

65

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 06.07.2023 (Pika 10)***

Nuk mori pjesë në këtë çështje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përditësimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2021 – 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

(Vijon mbledhja nën drejtimin e z. Rusi.)

Ilir Rusi: Në vijim mbledhja do të drejtohet nga unë Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor për shkak të një angazhimi institucional të Kryetares.

Vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës.

Shqyrtimi i projektvendimit për përditësimin e trupës gjyqësore “Për përditësimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2021 – 2024”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores znj. Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, ka për detyrë të përcaktojë gjykatat e shkallës së parë pranë të cilave kandidatët për

gjqtarë, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, do të kryejnë praktikën profesionale. Me vendimin nr. 316, datë 22.07.2021 Këshilli ka proceduar për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës pranë të cilëve kandidatet për gjyqtarë do të kryenin këtë praktikë përgjatë viteve 2021-2024, listë e përditësuar me vendimin nr. 242, datë 30.06.2022. Theksoj këtu që Këshilli e miraton listën një herë në tre vjet.

Referuar numrit në rritje të kandidateve për gjyqtarë që do të zhvillojnë praktikën profesionale gjatë vitit 2023 dhe në vazhdim, si dhe pamundësisë për të qenë gjyqtar udhëheqës të një pjesë të gjyqtarëve të miratuar tashmë me këto vendime, për shkak të ngritjes në detyrë, mbarimit të statusit të magjistratit ose zbatimit ndaj tyre të masave disiplinore për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, është e domosdoshme që lista e miratuar të përditësohet sërish, me qëllim krijimin e mundësisë që kandidatët për gjyqtarë për periudhën 2023-2024 të kryejnë praktikën profesionale.

Referuar listës së miratuar dhe të përditësuar, rezulton se nga 55 gjyqtarë të përfshirë në trupën e gjyqtarëve udhëheqës, 9 (nëntë) prej tyre nuk mund të ushtrojnë këtë funksion pasi:

(i) 1 (një) gjyqtar është ngritur në detyrë;

(ii) 1 (një) gjyqtar nuk e ushtron detyrën pasi është në skemë delegimi për të gjykuar në Gjykatën e Apelit Administrativ;

(iii) 5 (pesë) gjyqtarë nuk e ushtrojnë efektivisht funksionin për shkak të pezullimit nga detyra si pasojë e zbatimit të masave disiplinore të shkarkimit nga detyra aplikuar me vendim të organeve të rivlerësimit kalimtar;

(iv) 2 (dy) gjyqtarë nuk e gëzojnë më statusin e magjistratit.

Për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve udhëheqës të cilët mund të ushtrojnë këtë funksion, zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve mentorë nëpërmjet ngritjes në detyrë të tyre në gjykata ku mentorimi nuk mund të kryhet dhe kërkesës gjithnjë në rritje për mentorim për shkak të rritjes së numrit të kandidatëve për gjyqtarë, Komisioni ka vlerësuar të domosdoshme përditësimin dhe plotësimin e trupës së miratuar, e cila ka nevojë të trajnohet gjithashtu. Për këtë arsye nga ana e Komisionit i është drejtuar thirrje për të shprehur vullnetin për të qenë pjesë e kësaj trupe, të gjithë gjyqtarëve që plotësojnë kushtet ligjore dhe ushtrojnë funksionin në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, gjykata të kategorisë të parë dhe të dytë (të mëdha

dhe të mesme) dhe me infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e kësaj praktike. I është drejtuar thirrje gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Durrës dhe Korçë por që nga data 1 korriku janë gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë që përfshin Vlorën dhe Gjirokastrën), dhe gjyqtarëve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Lezhë, Korçë dhe Vlorë.

Në përgjigje të thirrjes, janë 14 (katërmëdhjetë) gjyqtarët të cilët kanë shprehur interes: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}.

Nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në përgjigje të thirrjes për shprehje interesi, është dërguar në datën 20.06.2023 lista e gjyqtarëve të kësaj gjykate, e cila është e ndarë në seksion penal, civil dhe familjar, nga ku rezulton se në seksionin civil aktualisht ushtrojnë detyrën 18 gjyqtarë, në seksionin familjar 6 gjyqtarë dhe në seksionin penal 18 gjyqtarë. Ndërkohë, janë dërguar edhe vendimet e këshillave të gjykatës për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Fier dhe Shkodër, të cilat gjithashtu janë të ndarë në seksione, me përjashtim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë e cila nuk e ka bërë ende ndarjen në seksione.

Sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar të nevojshme përditësimin e trupës nëpërmjet:

(i) Përfshirjes së gjyqtarëve që kanë shprehur gatishmërinë për t'u bërë pjesë e trupës së gjyqtarëve udhëheqës (që kanë shfaqur rishtazi vullnetin);

(ii) Heqjes nga lista të gjyqtarëve udhëheqës që rezultojnë aktualisht në pamundësi për të ushtruar funksionin për shkak se janë ngritur në detyrë dhe mentorimi kryhet vetëm në gjykatat e shkallës së parë;

(iii) Janë hequr ata gjyqtarë të cilët nuk e kanë më statusin e magjistratit;

(iv) Ata gjyqtarë që janë nën efektin e një mase disiplinore e cila veç faktit që nuk të bën efektiv në detyrë por është edhe kusht ndalues për të qenë mentor.

Nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të gjithë këta gjyqtarë plotësojnë kriterin e përvojës profesionale. Jo të gjithë kanë vlerësimin e fundit etik dhe profesional por gjithsesi kjo është për t'u mbajtur parasysh nga ana e Këshillit

në programet e vlerësimit që do të miratojë. Për sa i përket trajnimeve, po ta shikoni edhe nga materialet që i bashkëngjiten relacioni, jo të gjithë gjyqtarët e përfshirë në listë janë përfshirë në trajnime, por gjithsesi kjo është një çështje që duhet mbajtur nga Këshilli kur të caktojë gjyqtarët në mentorim, ku gjyqtarët e trajnuar duhet të kenë përparësi për t'u trajtuar si mentorë. Për sa i përket kriterit të parashikuar 33, pika 3, shkronja b) dhe atë të parashikuar në shkronjën d), jemi në pamundësi objektive për marrjen e informacionit për sa i përket mosrespektimit të afateve ligjore në gjykim kryesisht për kërkesa të ngutshme me afate ligjore, por duke marrë parasysh që ka një prezumim që kërkesat me natyrë të ngutshme dhe me afate ligjore shqyrtohen të gjitha brenda afatit, ka një prezumim që ato respektohen nga të gjithë gjyqtarët.

Për sa i përket hartimit të projektvendimit, në pjesën e parë të tij parashikohet pikërisht përditësimi i trupës të miratuar me vendimin nr. 316, datë 22.07.2021, të përditësuar me vendimin nr.242/2022.

Në këtë listë janë përfshirë:

(i) të gjithë gjyqtarët e listës së mëparshme dhe vazhdojnë ushtrojnë efektivisht funksionin pranë gjykatave respektive, shumica e tyre janë edhe të trajnuar në mentorim.

(ii) janë përfshirë edhe gjyqtarët që kanë shfaqur rishtazi vullnetin, që i janë përgjigjur thirrjes si dhe që plotësojnë kushtet sipas nenit 33, pika 3 shkronjat a, ç dhe d të ligjit.

Janë hequr nga lista gjyqtarët të cilët nuk e ushtrojnë funksionin në gjykatat respektive për shkak të ngritjes në detyrë, që kanë humbur statusin si dhe ata që janë nën efektin e masës disiplinore të pezullimit për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Në pikën e dytë të projektvendimit parashikohet detyrimi që të gjithë gjyqtarët e listës t'i nënshtrohen trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës.

Në pikën e tretë parashikohet njoftimi i vendimit shkollës si dhe të gjithë gjyqtarëve të miratuar listës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime nga anëtarët prezent në mbledhje?

(Nuk ka diskutime)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përditësimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2021 – 2024”.

Mbështetur në legjislacionin përkatës, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi:

1. Të përditësojë trupën e gjyqtarëve udhëheqës, për periudhën trevjeçare (2021 - 2024), të miratuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 316, datë 22.07.2021, përditësuar me vendimin nr.242, datë 30.06.2022, sipas listës bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Gjyqtarët udhëheqës sipas pikës 1 të këtij vendimi, angazhohen për të ndjekur gjatë kësaj periudhe, trajnimet e nevojshme pranë Shkollës së Magjistraturës.

3. Ky vendim t’i njoftohet Shkollës së Magjistraturës dhe gjyqtarëve udhëheqës.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 11 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Hallunaj.

* * *

(Pika 10 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.07.2023)

Pika 12 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 4. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 5. Alban Toro | (anëtar) |
| 6. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Fatmira Luli**, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Irena Plaku**.

Nuk mori pjesë në këtë çështje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

12 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

(Rilidhet mbledhja nëpërmjet platformës, pas shqyrtimit të çështjes së zhvilluar vetëm në prezencën e anëtarëve.)

Çështja e fundit e cila u shtua në rendin e ditës për t’u trajtuar lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Fjala i jepet relatorit të kësaj çështjeje për të relatuar relacionet e përgatitura nga Komisioni si më poshtë.

Relacioni i parë i relatuar nga zoti Hallunaj lidhet me caktimin e gjyqtarit në **Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër** për një çështje penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

1. Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështje gjyqësore të veçantë penale, të jetë Gjykata e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

2. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështje gjyqësore të veçantë penale të jetë 1 (një).

Lidhur me përjashtimet nga shorti, Komisioni propozon:

Të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, konkretisht: z. Artan Hajredinaj.

Të përjashtohet nga shorti: znj. {...} dhe znj. {...}, pasi Këshilli me vendimet nr. 321 dhe nr. 322, datë 14.06.2023 ka vendosur: “Komandimin e gjyqtarës znj. {...}/znj. {...} në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë. 2. Afati i komandimit është 5 (pesë) vjet dhe fillon më datë 15.07.2023.”

Pas relatimit, anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime apo diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Ilir Përdeda.

Relacioni i dytë i relatuar nga zoti Hallunaj lidhet me caktimin e gjyqtarëve në **Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës** për dy çështje penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1,

të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3 (tre).

Lidhur me përjashtimet nga shorti, Komisioni propozon:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti Zv.Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, konkretisht: z. Sokol Shehu.

Pas relatimit, anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime apo diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Tonin Sterkaj (relator), Arbër Çela dhe Besmir Stroka (anëtarë).

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Tonin Sterkaj.

Relacioni i tretë i relatuar nga zoti Hallunaj lidhet me caktimin e gjyqtarëve në **Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër** për tre çështje, dy penale dhe një civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 (tre) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 (dy).

Lidhur me përjashtimet nga shorti, Komisioni propozon:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti zv.kryetarja e Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, konkretisht: znj. Suela Xhani.

Pas relatimit, anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime apo diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (çështja nr. 89), gjyqtarët Dejvi Çelçima dhe Fatmir Ndreu.

Për çështjen nr. 2, penale (çështja nr. 91), gjyqtari Dejvi Çelçima.

Për çështjen nr. 3, civile (çështja nr. 74), gjyqtari Fatmir Ndreu.

Relacioni i katërt i relatuar nga zoti Hallunaj lidhet me caktimin e gjyqtarëve në **Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** për katër çështje penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 (katër) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 4 (katër) çështjeve gjyqësore të veçanta të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e

profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 (katër) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4 (katër).

Për çështjet me numër rendor nr. 3 dhe nr. 4 në tabelë, duke qenë se është i njëjti procedim penal dhe kërkohet plotësimi i trupit gjykues për seancat paraprake respektive, në pajtim me parashikimin K.Pr.Penale, përkatësisht 332/1 ku për përcaktohet se: “Kërkesat për dërgimin për gjykim të çështjeve të ndara nga i njëjti procedim penal, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar”, do të caktohet një gjyqtar për 2 kërkesat përkatëse.

Propozohet që çështjet me numër rendor nr. 3 dhe nr. 4 në tabelë të shortohen në një raund të dytë, me qëllim që përjashtohen nga shorti gjyqtarët që do të plotësojnë trupin gjykues për çështjen me numër rendor 1, si procedime të lidhura.

Lidhur me përjashtimet nga shorti, Komisioni propozon që të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore (referuar relacionit).

Bashkëlidhur gjendet edhe lista e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret për të qenë pjesë e shortit.

Pas relatimit, anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime apo diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (çështja nr. 85), gjyqtarët Esmeralda Xhili dhe Petrit Çomo.

Për çështjen nr. 2, penale (çështja nr. 84), gjyqtarja Entela Shedula.

Për çështjen nr. 3, penale (çështja nr. 20/140), gjyqtari Aurel Arapi.

Për çështjen nr. 4, penale (çështja nr. 65), gjyqtari Aurel Arapi.

Mbyllen procedura e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor